



DINJITETI NJERËZOR DHE RESPEKTI RECIPROK

Description

Tim Winter

FJALA E MBAJTUR NË FORUMIN KATOLIK – MYSLIMAN,

ROMË, 5 NËNTOR 2008

Fragment i shkeptur nga libri: Një fjalë e njëjtë : kumt dhe përqsasje : një burim për Famullitë dhe Xhamitë, (Botime Erasmus, Tirane: 2011).

dhembshuria e Zotit. Takimi ynë në këtë vend historik është, me lejen e Zotit, një kremtim dhe një shenjë shprese. Kremtim meqenëse të gjithë së bashku ne i festojmë fjalët e shpallura të Zotit, të ushqyer dhe të mbështetur për ta bartur lajmin e vërtetë dhe pajtimin drejt bashkësive që Eminenca, shkëlqesi, të ftuar të shquar dhe miq. Paqja qoftë me ju, dhe mëshira e

përfaqësojmë. Dhe shpresë në bindjen se, vështrimi shqyrtues i Përtejme, i cili drejtohet sigurisht kah diskutimet dhe gjendja e zemrave tona gjatë këtyre ditëve, do t'i vërejë të metat tona të shumta dhe do të jetë shenja nën të cilën shkëmbimet më të mira dhe të sinqerta të të dyja feve tona në të shkuarën do të vijojnë të na frymëzojnë, ndërsa gjejmë mënyra të reja dhe fituese për të tejkaluar qoftë keqkuptimet e qoftë gabimet në qëllim, që në kohët e shkuara na kanë shpënë në mosmarrëveshje të papëlqyeshme prej Zotit. Për të gjithë ne është e qartë se sa e afërt është marrëdhënia midis temës së madhe të diskutimit të djeshëm¹⁷ dhe temës për të cilën flasim sot. Në të vërtetë, është kjo marrëdhënie që qëndron në zemër të dallueshmërisë së përgjigjes fetarendaj krizës së modernitetit. Epoka e jonë është një periudhë gjatë së cilës janë bërë përpjekje fisnike për ta vlerësuar njerëzimin përmes përmbledhjeve rregullatore për të drejtat njerëzore dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të tipeve të ndryshme. Megjithatë, filozofia që mëton të jetë themeli i përpjekjeve të sotme, në klimën mbizotëruese shekullare të çastit, duket se gjallon në gjendje krizash. Iluminizmi, burim i shumëçkaje të vlefshme për kuptimin tone bashkëkohor të dinjitetit njerëzor, u sulmua në kohën e tij nga mendimtarë fetarë dhe gjithashtu disa të tjerë shekullarë, të cilët i vunë në dyshim pretendimet për një etikë të pastër shekullare dhe për një domosdoshmëri kategorike të rrenjosur në optimizmin e pamatë për aftësinë morale të arsyes dhe shkencës së pandihmuar. Pjesërisht, ky pesimizëm u provua të ketë qenë i arsyeshëm. Europa, djepi i Iluminizmit, është sot djepi i një relativizmi postmodern të tipit më të

fortë. Fryma që u çlirua prej kutisë së Pandorës nga Lumières dhe Aufklärung, dhe në vendin tim nga Locke dhe Hume, në disa raste është provuar të ketë qenë aleate e engjëjve; por në të tjerë, të ketë qenë pagabueshëm prej mbretërisë së skëterrshme të përmbysjes dhe armiqësisë. Europa – dhe këtu unë flas si european – është në krizë, dhe besimtarët, të cilët për një kohë të gjatë, herë me të drejtë dhe herë të nënshtruar, i dolën kundër projektit të Iluminizmit, thirren sot të qetësojnë dhimbjet e saj të thella. Të krishterët dhe myslimanët, si ndjekës së dy feve më të mëdha në Europë, duhet sigurisht të punojnë së bashku si kurrë më parë për të gjetur një kurë. Duhet të punojmë po ashtu për të garantuar se sëmundja e zemrës së Europës, e shprehur sot përmes një indiference fetare pothuaj të pashoqe, nuk do t'i eksportohet botës.

Ky është, në fakt, drejtimi kah i cili dëshiroj t'i udhëheq vërejtjet e mija. Si qytetar dhe

përkrahës i Bashkimit European, e gjej veten pjesë të një shoqërie tragjike pa Zot. Së fundmi, një sociolog botoi një libër me titull The Death of Christian Britain [Vdekja e Britanisë së Krishterë]¹⁸, dhe kjo më dhemb thellë sepse, në fakt, ajo çka po vdes është një takëm bindjesh monoteiste dhe një jetë lutjesh dhe dhurimi njerëzor që ne, si myslimanë, dëshirojmë ta vërejmë të lulëzojë përreth nesh. Sidoqoftë, unë jam po ashtu anëtar i Islamit. Kjo ndërthurje e europianes dhe islames do të ishte më pak e vështirë nëse Europa do të kish pasur më tepër besim në dimensionin e trashëgimisë së saj të krishterë. Preferoj të jetoj në një shoqëri të krishterë, në vend të një të tilla shekullare.

Është kjo ndjesi humbjeje që e motivon angazhimin tim të veçantë në procesin e Fjalës së Njëjtë. Sikurse jeni të vetëdijshëm, takimi i këtij Forumi këtu në Romë është pasojë e iniciativës së nisur një vit më parë prej dijetarëve myslimanë të cilët, të shqetësuar prej gjendjes së tashme të botës, zgjatën dorën kah krerët shpirtërorë të Krishtërit për t'i mbështetur me dashamirësi. Përtej marrëveshjes së përgjithshme të firmëtarëve të dokumentit se, bota është në nevojë për shërim dhe se myslimanët janë mbledhur për ta thirrur njerëzimin drejt principeve të pavdekshme të dashurisë së Zotit dhe të fqinjit, arsyeja ime për ta nënshkruar dokumentin ishte se personalisht jam posaçërisht i shqetësuar nga mungesa e besimit në Europë dhe rënia e dinjitetit njerëzor, dhe e rënia e shkueshmërisë së mirë që rrjedhon për pasojë.

Nëse në shumë hapësira të brendshme qytetesh, dhe gjetiu në rritje, myslimanët jetojnë si bashkësi përbërëse europiane domethënëse, atëherë qëllimet e përbashkëta janë të shumta për të punuar së bashku kundër vështrimit të rrënuar të kontinentit tonë të sotëm ndaj prirjes njerëzore dhe fatit. Dhe është besimi im se, këmbëngulja e tashme e Selisë së Shenjtë në ringjalljen e trashëgimisë së arsyes fetare është tërësisht e drejtë. Është e rëndësishme të rikujtojmë se Kisha Katolike, si institucioni sot më i vjetër i botës, ka një kujtesë të gjatë që përfshin ngjarje të tjera, të mëparme, kur ardhmëria shfaqej e errët. Shën Benedikti i Nursisë, njëmijë e pesëqind vite më parë, jetoj gjatë pushtimeve barbare, të cilat ngjanin se e kërcënonin Europën me relativizëm politeist dhe me etikën jonjerëzore të lakmisë dhe sundimit. Kura, sikurse vërente Benedikti, ishte fuqia e pamatë e sigurisë së shpallur nga lart, e mbrojtur dhe e përforcuar nga arsyeja.

Me udhëheqjen e tashme, Selia e Shenjtë është e mirëvendosur për t'i justifikuar

pohimet e saj për të qenë një mbështetje për arsyen e vërtetë. Dhe kjo e vendos atë, sipas këndvështrimit mysliman, në një pozitë ideale për të bashkëpunuar me myslimanët, dhe me të tjerë sigurisht, në detyrën e madhe të mposhtjes së pesimizmit dhe rendit të opinionit arbitrar.

Teologjia islame, sikurse e dimë tashmë, disa prej metodave dhe kategorive të

hershme të saj i mori prej të krishterësh të tillë si Gjon Filoponusi, të cilin ne e njohim si Jahja el Nahvi. Gjithashtu, në rrethana kyçe gjatë historisë së saj, Europa e krishterë është forcuar

nga studimi i mendimtarëve islamë. Kush mund ta mohojë ndikimin e Ibn Rushdiut, gjykatësit të Sheriatit të Kordovës, në Europën e epokës së Shën Thoma Aquinas-it ? Ose rëndësinë e Gazaliut, i njohur nga latinët si Algazel, në përgënjeshttrimin e tij të ashpër ndaj metafizikës së gabuar dhe herë-herë thujse pagane të Avicenës ? Ose të mutekelim-inëve, teologëve myslimanë të njohur si 'Loquentes' në Perëndim, rreptësia e të cilëve në përdorimin e arsyes i bëri ata bashkëbisedues idealë, megjithëse në largësinë e lipsur nga kultura e kohës, për më të rreptët ndër mendimtarët e krishterë¹⁹ ? Sikundër Europa e sotme përballet me barbarë të rinj, të cilët janë postmodernistët dhe relativistët e tjerë që, jo më të ardhur nga jashtë, vijnë prej një zhvillimi të jetës së saj të brendshme, ky pikëtakim mund të provohet i një vlere jetike. Respekti ynë i ndërsjelltë mund të bazohet në praktikën e përbashkët të ballafaqimit racional ndaj sëmundjes së Europës.

Nevoja për ta bazuar dialogun tonë në ide nënvijëzohet më tej prej domosdoshmërisë së misionit, i spikatur në të dyja traditat. Një bashkëpunim i thjeshtë në aspekte praktike do të

rrezikonte të mbyste zërin e bashkëbisedimit teologjik, i cili është sigurisht më pranë thelbit të cilitdo përafrimi me kërkesat fetare.

Ndër studentët e mëdhenj europianë të Islamit gjatë shekullit të fundit, shumë ndër më

të mëdhenjtë qenë besimtarë katolikë të cilët, në ndjekje të Maritain-it dhe të interesit neotomist* në filozofinë arabe, thelluan kontributet në kuptimin teologjisë myslimane. Midis tyre, meritojnë të citohen dijetarët e mëdhenj domenikanë, Georges Anawati dhe Louis Gardet, manuali i teologjisë islame i të cilëve, hartuar më 1948-ën, tregon rëndësinë e arsyes në kulturën islame dhe vlerën e krahasimit të detajuar me tomismin²⁰. Studimi i tyre i Islamit u përqendrua në hanbelizëm dhe esh'arizëm. Ndërkohë, maturidizmi, shkolla e tretë e madhe e teologjisë sunite, tërhoqi interesin e veçantë të Josef Van Ess-it të Universitetit Tu?bingen. Van Ess-i na rikujtoi këmbënguljen e Maturidiut në racionalitetin e Zotit, cekur edhe në veprën e Gazaliut dhe shkollës së tij. Në historinë e tij të madhe katër-vëllimshe për teologjinë e hershme myslimane, Van Ess e thekson dendur këmbënguljen e Islamit në terrenin hyjnor të arsyes. Për më tepër, ai shkruan:

Krishtërimi flet për 'misteret' e besimit ; në Islam nuk ka kurrfarë të tilla. Për Shën Palin

arsyeja i përket mbretërisë së 'mishit', për myslimanët arsyeja, 'akl, ka qenë gjithherë aftësia

kryesore që Zoti u ka dhuruar qenieve njerëzore²¹.

Van Ess, dhe të tjerë dijetarë më të hershëm katolikë, i kanë dhuruar botës një shërbim

të pallogaritshëm. Veprimtarët shekullarë të një gjenerate më të hershme dëshironin ta shihni Islamin si adhuresin e një Zoti të paarsyeshëm, një tirani legalist, krejtësisht i tërhequr prej

analogjisë apo shqetësimeve njerëzore. Islami shpesh përafrohej me Judaizmin, të cilin një

orientalizëm më i vjetër zgjodhi ta shohë në mënyrë analoge si 'semit' në mospranimin e tij të arsyes helenike apo asaj të tipeve të tjera. Shembulli i mëposhtëm është marrë prej Ernest

Réan-it, kryeracionalistit, i cili më 1862 shkruante :

Në kohën e sotme, parakushti thelbësor për përhapjen e qytetërimit europjan është shkatërrimi par excellence i gjësë semite [...] shkatërrimi i Islamit [...] Islami është mohimi më i plotë i Europës : Islami është fanatizëm [...] E ardhmja, zotërinj, është rrjedhimisht e Europës dhe vetëm Europës [...] Këtu është lufta e përjetshme, lufta që do të përfundojë vetëm atëherë kur biri i fundit i Ishmaelit do të vdesë në mjerim, ose do të dëbohet përmes terrorit në thellësitë e shkretëtirës²².

Réan, heroi i iluministëve, është i bindur se Islami dhe Judaizmi nuk kanë kurrjë për të thënë për sa i përket idesë së dinjitetit njerëzor. Do të shtonim se, kuptimi i tij për Krishtërimin klasik sigurisht që nuk është më i favorshëm.

Sajë mirësisë së Zotit, këto kohëra i kemi lënë pas, dhe myslimanët lypen t'i falenderojnë dijetarët katolikë për dëbimin e kategorive të vjetra dhe qartësisht antisemite, në favor të mirëkuptimit të Islamit si një besim në të cilin besimi i arsyeshëm në një Zot të arsyeshëm është qendror në teologjinë serioze.

Këta dijetarë katolikë kanë mundësuar një imazh të Islamit, i cili në aspekte kyçe puqet me kuptimin modern katolik të dinjitetit të brendashkruar të qenieve njerëzore. Sheh el Buti i është referuar shpesh shumë prej treguesve kur'anorë të këtij principi. 'Ne me të vërtetë i kemi nderuar bijtë e Ademit' thotë Kur'ani (Isra, 17 :70). Ademi vetë ishte krijesa ndaj të cilit Zoti urdhëroi vetë engjëjt të përuleshin (Araf, 7 :11). Dhe kjo sepse Zoti ka krijuar në të një shpirt i cili vjen prej vetë Zotit (Hixhri, 15 :29 ; Sexhde, 32 :9 ; Sad, 38 :72)²³. Kësodore, teoricienët tanë, dhe veçanërisht maturiditë dhe hanefitë, këmbëngulin se të drejtat janë të lindura me qeniet njerëzore, në vend se të akorduara më pas, në një mënyrë që mund t'i nënshtrojë ato ndaj pranimin fetar. Dëshiroj të citoj në lidhje me këtë fjalët e Imam Sarahsit,

juristit hanefi, i cili ndërroi jetë më 1090:

Në krijimin e qenieve njerëzore, Zoti dhuroi me mirësi për ta inteligjencën dhe mundësinë për të bartur përgjegjësi dhe të drejta. Kjo, në mënyrë që t'i bënte ata të gatshëm për detyrat dhe të drejtat e vendosura prej Zotit. Më pas, Ai u dha atyre të drejtën e paprekshmërisë, lirisë dhe pronës për t'u mundësuar të vijonin jetët e tyre në mënyrë që ata të mund të kryenin detyrimet që ata kanë marrë mbi vete. Atëherë, këto të drejta për të bartur përgjegjësi dhe për të gëzuar të drejta, liri dhe pronë gjallojnë në qenien njerëzore që kur ai lind. Fëmija i papërgjegjshëm dhe i rrituri i përgjegjshëm janë njëlloj për sa u përket këtyre të drejtave. Kjo është mënyra se si njeriu i është dhënë personaliteti i tij që kur ai u lind, që Zoti ta ngarkojë atë me të drejta dhe detyra që prej lindjes. Në këtë vështrim, fëmija i papërgjegjshëm dhe i rrituri i përgjegjshëm janë të barabartë.²⁴

Kjo vëmendje e lartë ndaj dinjitetit të personit njerëzor në kohët mesjetare prodhoi shoqëri në të cilat bashkësitë jomyslimane lulëzuan për shekuj. Natyrisht, bindja ishte se të drejta të caktuara barteshin më të plota prej atyre që e pranonin shpalljen e fundit të Zotit në Kur'an. Kjo bindje nuk përbënte aspak çudi për kohën e saj, dhe në të vërtetë mund të shihet si normative në një kuptim të caktuar të fesë tradicionale. Le të kujtojmë se, ende më pranë nesh, Papa Leoni XIII, autor i enciklikës Libertas, nyjëtoi një meditim të shkëlqyer teologjik për natyrën e dinjitetit njerëzor. Ky është mësimi i tij:

Drejhtësia rrejdhimisht e ndalon, dhe vetë arsyeja e ndalon që Shteti të jetë i pazot, ose të pranojë një linjë veprimi e cila mund të përfundojë në një gjendje të patënzot – domethënë, trajtimin e feve të ndryshme (sikurse i quajnë) njëlloj, dhe t'u dhurojë atyre padallim të drejta dhe privilegje të njëjta²⁵.

Historikisht, myslimanët do të binin dakord me këtë mësim. Disa syresh vijojnë të jenë dakord me të edhe sot. Por ashtu sikundër mësimi papnor lipset të ndryshojë dhe ndryshon edhe në çështjet e një rëndësie kaq të thellë, sot lypet gjithashtu, si një çështje me një urgjencë të caktuar, që myslimanët ta drejtojnë me bamirësi vështrimin kah dështimet me anëtarët e pakicave fetare²⁶. Por – dhe këtu futemi në një territor më pak të njohur – myslimanët thirren gjithashtu nga i njëjti mësim i madh i patjetërsueshëm i dinjitetit të njeriut, të shtyjnë qeveritë e tyre të ndryshme për të respektuar gjithashtu edhe të drejtat e myslimanëve. Në fort vende myslimane, e drejta e myslimanëve për ta praktikuar plotësisht fenë e tyre, për t'u mbathur me veshje të urdhëruara nga tradita në publik dhe në vende arsimore, për të ndërtuar xhami dhe shkolla dhe për të kërkuar lirisht reforma prej sundimtarëve të cilët i konsiderojnë të korruptuar, është shkurtuar. Myslimanët duhet gjithashtu, përtej thirrjes për rivendosjen e nevojshme të idealit kur'anor të dinjitetit dhe nderit të krijesës abrahamike, në vende ku ata përbëjnë shumicë, të jenë solidarë me myslimanët që jetojnë në vende të Europës, në të cilën rritja e një paganizmi të ri tribal është duke e bërë jetën e besimtarëve myslimanë të pamundur. Ne e njohim dhe e pranojmë me respekt dhe mirënjohje premtimin e klerit dhe besimtarëve katolikë për t'i tejkaluar

pengesat me të cilat përballen besimtarët myslimanë në Europë, veçanërisht në bashkitë të cilat kontrollohen nga formacionet politike të skajit të djathtë.

I jam kthyer kështu, sikurse edhe duket qartë, temës sime së tragjedisë së Europës.

Ndërkaq, kam shfaqur edhe besimim tim se, si mbështetës të Popullit të Librit ne e vajtojmë krizën shpirtërore të Europës dhe u dëshirojmë më të mirën Kishave në betejën e tyre për shërimin e saj. I thërras këtu kujtimin të ndërgjegjjes katolike të Belgjikës, Jacque Neiryneckut. Në romanin e tij, *Le siège de Bruxelles* [Rrethimi i Brukselit], Neiryneck ravijëzon një ardhmëri të makthshme, në të cilën shovinizmi ka sjellë persekutimin dhe dëbimin e pakicësë urreyer myslimane të Belgjikës ; por ai përfundon duke treguar se rrjedha e përgjithshme e zërave njerëzore në Islam dhe Krishtërim përfundimisht do të triumfojnë²⁷.

Mirëbesimi im është se, bashkëpunimi dhe respekti reciprok do të triumfojnë vërtet

kundër barbarizms.

Tashmë, do t'i kthehem një arsytimi të brendshëm mysliman. Disa myslimanë duket

se besojnë se ky ndërveprim shkueshmërie të mirë dhe morali, dhe mbështetjeje reciproke në çështje të natyrës shoqërore duhet të jetë i ndarë prej vëmendjes ndaj teologjisë. Në disa raste,

dëgjohet edhe mendimi se Krishtërimi, i rrënjosur në besimin e mëkatshmerisë njerëzore, është mosbesues ndaj intelektit dhe se doktrinën e tij janë të bazuara thjesht në një besim të

verbër. Kjo ndërkaq kundërshtohet nga Islami i cili, sikurse pohojnë këta mendimtarë, është para së gjithash feja e arsyes dhe e një Zoti të arsyeshëm. Këto perceptime gjenden në polemikën e Rashid Ridasë dhe shkollës së tij, ende mjaft të përfillshme²⁸. Dëgjohen gjithashtu këto perceptime edhe ndër myslimanë më pak të kultivuar. Sakaq, është i qartë prej cilitdo studimi të doktrinës katolike se, arsyeja natyrale është qëndrore në ndërmarrjen katolike intelektuale. Kjo do të thotë padyshim se, pretendimi që bashkëpunimi ynë duhet të jetë thjesht pragmatik është i keqorientuar. Ka ardhur koha që myslimanët ta mirëpresin bashkëpunimin me katolikët me vetëdijen se katolicizmi, sikur Islami, flet gjuhën universal të arsyes.

Ndërsa të arrihet kjo, mbetet ende shumë për të bërë. Së bashku, myslimanët dhe të krishterët katolikë, përbëjnë më tepër se dy miliardë shpirta : më tepër se një të tretën e popullatës botërore. Dokumenti i Fjalës së Njëjtë thekson, në një perspektivë shkrimesh të shenjta, jo vetëm nevojën për të pohuar principet e përbashkëta abstrakte për dashurinë e Zotit dhe të fqinjët, por të tregojë sinqeritetin e angazhimit tonë në veprimin baritor. Të dyja principet janë në fakt simbiotike.

Jemi të ndërgjegjshëm se kjo e jona është një kohë sfidash për marrëdhënien tonë. Ka

myslimanë, ka edhe të krishterë që dëshirojnë që takimi ynë këtu të mos kishte ndodhur. Fjala e Njëjtë është dënuar nga disa zëra myslimanë; dhe disa të krishterë kanë shprehur tjetërsimin e tyre prej përgjigjeve të ngrohta dhe pozitive të krishtera që erdhën nga Yale, Pallati Labeth dhe qendra të tjetra të ndërgjegjjes së krishterë. Në vende të ndryshme, marrëdhënia jonë po njihet përmirësim; në të tjerë, duket se vuan nga një mungesë e vështirë. Urdhërimi për ta dashur Zotin dhe fqinjin, i cili në praktikë përbën një urdhërim të vetëm, nuk gjen bindje të gjithëshme në praktikë dhe në zemrat tona. Ka një frikë të mirëqenë të krishterë ndaj ekstremizmit mysliman. Dhe ka një frikë të pamohueshme myslimane ndaj asaj çka Hans Ku?ng në librin e tij për Islamin e ka quajtur 'politika e jashtme agresive

imperialiste'29 e Amerikës, e drejtuar, sikurse shihet prej ndokujt, nga kombëtaristë të krishterë midis të cilëve 'mentaliteti i kryqëzatave është tashmë duke u ringjallur'³⁰. Të dyja palët nevojitet ta kuptojnë frikën e Tjetrit.

Si myslimanë, të thirrur për të qenë zemërhapur kundrejt themeluesve të të treja feve abrahamike, ne i vuajmë veçanërisht këto tensione. Iniciativa e Fjalës së Njëjtë është një shprehje e kësaj vuajtje. Por lipset të ecim përpara. Dhe një përkrahës i admirueshëm i kësaj është treguar Eminenca e Tij, Kardinali Tauran, në mesazhin e tij për përmylljen e Ramazanit, dalë gjashtë javë më parë. Ai e titullonte letrën e tij : Të krishterët dhe myslimanët : së bashku për dinjitetin e familjes. Këtu, kardinali komenton solidaritetet e shkuara midis myslimanëve dhe të krishterëve në detyrën e madhe të mbrojtjes së këtij institucioni thelbësor të shoqërisë dhe lutet për bashkëpunim të mëtejshëm në të ardhmen.

Besoj se Eminenca e Tij ka plotësisht të drejtë dhe se ka indentifikuar një të njëjtë hapësirave më të rëndësishme, në të cilën angazhimi ynë i përbashkët ndaj dinjitetit njerëzor mund të gjejë shprehjen e tij në praktikë. Myslimanët dhe katolikët pa dallim, me gjithë përbuzjen e komentuesve shekullarë, e përkrahin me kurajë imazhin e martesës si kontekstin e duhur për shprehjen e seksualitetit njerëzor. Shenjtëria e Tij Papa Benedikt, në enciklikën e tij Deus Caritas Est i përkujtoi botës në kohën e duhur dinjitetin dhe shenjtërinë e dëshirës seksuale njerëzore. Erotika lipset të jetë pjesë e spiritualitetit tonë, jo një alternativë ndaj tij. Konteksti i duhur për këtë aspekt jetësor të dinjitetit tonë si qenie të mishëruara, është qartazi martesa. Këtu, myslimanët dhe katolikët do të dëshironin të ndaheshin në mendim prej një tendence të caktuar zvogëluese të kulturës bashkëkohore, që mëton se burrat dhe gratë janë të ndryshëm vetëm në mënyra të kushtëzuara prej shoqërisë, në vend se shprehje të ndër-këmbyera, por njëlloj të vlefshme, të aspektit të fuqisë së Atij që e krijoi njerëzimin sipas imazhit Hyjnor.

Le të huazojmë në një mënyrë analoge një mprehtësi prej teologjisë trinitariane të Hans Urs von Balthasar-it. Këtu, gjenialiteti i teologut zviceran tërheq vëmendjen kah marrëdhënia midis personave të trinisë. Ai shkruan: 'mënyrat hipostatike të qenies përbëjnë për njëra-tjerën kundërshtinë më të madhe që mund të mendohet [...] veçanërisht sepse interpenetrimi më intim që mund të mendohet bëhet i mundur'³¹. Duke shpërfillur pikëpamjen e varfëruar moderne ndaj gjinisë, ai vijon të identifikojë të marrët dhe të dhënë të personave të trinisë në terma të sinqertë gjinorë: principi mashkullor indentifikohet me fekonduesin, rolin dinamik, dhe ai femëror me pritësin dhe atë dritëlëshues³². Ky miratim i kuptimit të krishterë klasik të reciprocitetit të gjinive në jetën familjare, është qartësisht i afërt në përfundimet e tij me bindjet myslimane; edhe pse gjuha trinitariane për jetën e brendshme të Zotit është pamohueshëm larg besimit mysliman. Përfundimet e përbashkëta për vlerën e 'seksualiteteve alternative' sigurisht që do të vijojnë në këto gjedhe.

Një tjetër hapësirë në të cilën kemi punuar ndërkaq bashkarisht me ndikim të mirë,

tregohet në përgjigjen e shkëlqyer dhe të detajuar të Kryepeshkopit Rowan Williams ndaj Fjalës së Njëjtë³³. Ai vë në pah rëndësinë e mosmarrëveshjes Israelo-Palentineze si 'arsyen kryesore ose ndër më kryesoret që shqetësojnë së bashku të krishterët dhe myslimanët rreth e qark botës'. Myslimanët janë të bindur se Selia Apostolike, e shqetësuar për katolikët dhe bashkësitë e tjera të Jerusalemit, do të solidarizohet me besimtarët e krishterë dhe myslimanë të cilët, ndërsa nuk i pranojnë përgjigjet mizore dhe arbitrare terroriste, qëndrojnë me kurajë për të drejtat e tyre për dinjitet në tokën e tyre. Myslimanët janë ngazëllyer pa masë prej kurajës së shumë të krishterëve, sikudër ajo e ish-presidentit amerikan Jimmy Carter dhe Kryepeshkopit Desmond Tutu nga Cape Town, në dënimin e asaj të cilën ata e përshkruajnë si politika e 'aparteidit' të Israelit kundër bashkësive myslimane dhe të krishtera të

territoreve të pushtuara. Me të drejtë është thënë se, përkrahja e dinjitetit të popullit palestinez është shtegu më i sigurt drejt zemrave të myslimanëve, dhe ne mbetemi me besim se Vatikani do ta kujtojë këtë si një orvatje për të mbrojtur një zgjidhje të paqte dhe të drejtë për çifutët, myslimanët dhe të krishterët njëloj në Tokën e Shenjtë.

Sidoqoftë, në tokën e Zotit gjenden vende të tjera ku dinjiteti njerëzor nëpërkëmbet. Nuk është e drejtë për myslimanët, duke përfshirë edhe myslimanët arabë, të tërheqin vëmendjen ndaj vështirësive të palestinezëve dhe t'i kushtojnë më pak vëmendje viktimave të mizorisë së tashme në Darfur. Ky skandal nevojitet të shpjegohet dhe trajtohet urgjentisht. Së fundmi, tragjedia në Zairinë Lindore na fton të gjithëve të bashkojmë veprimin. Me siguri, kushdo mund t'i kujtojë marrëdhëniet e mira, të cilat ruheshin aq shpesh midis katolikëve dhe myslimanëve në Ruandën fqinje, edhe në kulmin e ngjarjeve tronditëse të fillimit të viteve 1990-34.

Këto fatkeqësi që shëmtojnë tokën e Zotit janë thirrje dhe gjykim. Ne nuk kemi qenë gjithnjë agjentët e paqes së Zotit. Është sigurisht një burim përhumbës për ne të mësojmë se, në

shekullin e njëzetë, njeriu më i kremtuar i paqes, Gandi, nuk qe as mysliman e as i krishterë. Si evropian, qytetar i një kontinenti krenar për trashëgiminë e tij monoteiste, vazhdoi të ndjej keqardhje prej kujtimit të luftërave të shekullit të shkuar, të cilat i tejkaluan qoftë në masë e qoftë në egërsi ato të cilitdo tjetër kontinenti.

Është e qartë se jemi thirrur t'i provojmë botës se jemi një forcë për të mirën. Kriza moderne e besimit shkaktohet gjithë e më shpesh prej një ndjesie se feja prodhon frutin e hidhur të armiqësië dhe mosmarrëveshjeve. Detyra jonë më urgjente atëherë, ndërsa kërkojmë vendin tonë si mbrojtës të dinjitetit njerëzor, është që të tregojmë në praktikë, dhe jo vetëm me fjalë, se mund të bashkëpunojmë së bashku për të mirën e përbashkët. Fatkeqësitë e

natyrës, dukshëm kaq të spikatura në kohën tonë të turbullt mjedisore, dëftojnë një fushë të

qartë për punë të përbashkët, dhe kushdo e ndjek me kënaqësi përparimin në bashkëpunimin midis CAFOD-it dhe Islamic Relief-it pas nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit historik më 2003, në të cilin ata zotohen për të mbështetur njëri-tjetrin në veprimtarinë e

punëve të emergjencës³⁵. Në vendin tim gjithashtu, Islamic Relief dhe Christian Aid nisin ekipe të përbashkëta myslimane-të krishtera në vende të Afrikës jugore sipas një skeme pilote, e cila premtim për bashkëpunim të mëtejshëm dhe më sistematik. Në manifestimin e madh Cut the Carbon [për reduktimin e emetimeve të gazit karbonik] në Birmingham, më 21 gusht 2007, Christian Aid dhe shoqata të ndryshme bamirëse myslimane treguan forcën shëruese ndaj një ngjarjeje publike, e cila e njofton botën se vuajtja e saj mjedisore mund të shërohet prej bashkëpunimit ndërfaqësor, grumbullimit të energjisë dhe burimeve për të trajtuar një problem që është shumë i madh për agjencitë e një feje të vetme.

Uria globale, që duket se po na afrohet gjithnjë e më pranë, nxitur ndoshta prej rritjes në shpenzimet e biokarburanteve, është duke krijuar ndërkaq një konkurs vdekjeprurës për burimet e pamjaftueshme në vendet e Botës së Tretë. Vdekjet nga uria raportohen në rritje dhe prodhuesit e vegjël po vuajnë. Në Indi, shifrat tronditëse tregojnë se 166 000 mijë fshatarë kanë vvarë veten që prej vitit 1997/36. Urtësia që ndajmë së bashku për sa i takon shpërndarjes së drejtë, mëshirës për nevojtarin, ligësisë së fajdes si edhe beteja politike në emër të të shtypurve duhet sigurisht të vendoset në përdorim në një fushatë të përbashkët në emër të atit tonë, Abrahamit, për të mbrojur ata që vuajnë në këtë mënyrë.

Kjo lipset të jetë veçanërisht detyra dhe barra jonë. Islami dhe katolicizmi janë në Europë. Por askush nuk mund të pretendojë një marrëdhënie të privilegjuar me këtë kontinent nga frika se mund t'i largojë të tjerët drejt statusit dytësor. Të dyja traditat tona kanë rrënjë të rëndësishme në Azi dhe Afrikë. Azia është në një kuptim kontinenti i privilegjuar, kontinenti i shpirtit, sepse Qielli e ka bërë atë vendlindjen e gjithë feve të mëdha. Sot, shumë pjesë të saj

lulëzojnë, por në të tjera dinjiteti njerëzor është duke vuajtur me trishtim. Në Afrikë, tashmë një kontinent i ndarë ngushtë midis Islamit dhe Krishtërit, thirrëmi të punojmë së bashku për atë çka kemi të njëjtë. Jezusi dhe Muhamedi nuk ishin vetëm përkrahës të të varfërve, ata jetuan midis të varfërve dhe sigurisht që do të ringjallen midis tyre. Ky është një aspekt jetik i vëllazërisë së tyre dhe tonës. Nëse ne jetojmë midis privilegjes, krenarë për titujt dhe veshjet tona të padobishme, por dështojmë të punojmë me duart dhe zemrat tona për ata që jetesën e kanë të rrezikuar, atëherë e kemi tradhëtuar principin abrahamik të nënshtrimit ndaj vullnetit të Zotit, i cili na mëson se duhet të jemi të gatshëm të sakrifikojmë edhe atë që është më e çmuar për ne, pa u lëkundur, me plot zemër për hir të Zotit.

E pe atë që e përgënjeshton botën tjetër ?

Është po ai që ashpër dëbon bonjakun

Dhe nuk nxit të ushqejë të varfrin.

Mjerë ata që kur falen,

Janë të pakujdeshëm,

Ata që vetëm shtiren për sy e faqe,

Dhe pengojnë dhënien e ndihmës.

(Maun, 107)

Referenca

17 Ish rënë dakort se Dita Një e Forumit do t'i kushtojë temës së 'Dashurisë së Zotit dhe Dashurisë së Fqinjit'.

18 Callum G. Brown, The Death of Christian Britain (London: Routledge, 2001).

19 C.E. Butterworth dhe B.A. Kessel (bot.), *The Introduction of Arabic Philosophy into Europe* (Leiden: E.J.W. Brill, 1994);

H.A. Wolfson, 'The Twice-Revealed Averroes', *Speculum* 36 (1961), 373-92; Jean Jolivet, 'The Arabic Inheritance', në

Peter Dronke (bot.), *A History of Twelfth-Century Western Philosophy* (Cambridge: Cambridge University Press, 1988),

f.113-47.

* Bëhet fjalë për filozofin e njohur katolik Jacques Maritain (1882-1973) dhe për rikthimin tek mendimi i Thomas

Aquinas-it (shënim i përkthyesit).

20 Louis Gardet and M.-M. Anawati, *Introduction à la théologie musulmane: essai de théologie comparée* (Paris: J.

Vrin, 1948).

21 Josef Van Ess, *The Flowering of Muslim Theology* (Cambridge MA: Harvard University Press, 2006), f. 153-4.

22 Ernest Rénan, *De la part des peuples sémitiques dans l'histoire de la civilisation, discours d'ouverture du cours de langue*

hébraïque, chaldaïque et syriaque au College de France (Paris: Michel Lévy, 1862), f. 27-8.

23 Muhamed Said Ramadan el Buti, *Men huue sejid el kader fi hayat el insan* (Damascus, 1975).

24 Cituar në Recep Sentu?rk, 'Minority Rights in Islam: From Dhimmi to Citizen', në Shireen T. Hunter and Huma

Malik (bot.), *Islam and Human Rights: Advancing a US-Muslim Dialogue* (Washington DC: Center for International and

Strategic Studies, 2005, 67-99), f.74.

25 Pope Leo XIII, *Libertas*, 21.

26 Abdal Hakim Murad, *Qur'anic truth and the meaning of dhimma* (Dubai: Kalam Research and Media, 2010).

27 Jacques Neiryck, *Le siège de Bruxelles, roman* (Bruxelles: Editions Labor, 2005).

28 Rashid Rida, *el Uahi el Muhamedi* (Kairo: al-Manar, AH 1352), f. 195.

29 Hans Ku?ng, Islam (Oxford: Oneworld, 2007), f. 453.

30 Ku?ng, f. 311

31 Hans Urs von Balthasar, Theo-drama II, 258, cituar në Rowan Williams, 'Balthasar and the Trinity', 37-50 i Edward

41. Oakes SJ dhe David Moss (bot.), The Cambridge Companion to Hans Urs von Balthasar (Cambridge, 2004), shih f. 41.

32 Theo-drama V, cituar në Rowan Williams, 'Balthasar and the Trinity', f. 45.

33 Rowan Williams, 'A Common Word for the Common Good' (www.archbishopofcanterbury.org/1892).

34 Anne Kubai, 'Walking a Tightrope: Christians and Muslims në Post-Genocide Rwanda', Islam and Christian-Muslim

Relations, 18 (2007), f. 228-34.

35 www.cafod.org.uk/partnership/other-faiths

36 Randeep Ramesh, The Guardian, 1 March 2008.

Date Created

20/07/2019

Author

erasmusi